



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS

Kryetari i Komunës

01 Nr. 07- 3276 /14

Klinë më 30. 06. 2014

EKSTRAKT-PROCESVERBAL

Nga TAKIMI ME PUBLIKUN *mbi rrjedhat e qeverisjes në Komunën tonë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 i mbajtur me datën 30. 06. 2014 në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim në orën 13:00.*

R e n d i i d i t ë s:

1. *Rrjedhat e qeverisjes në Komunën e Klinës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, të arriturat, vështirësitet, synimet dhe investimet kapitale,*
2. *Të ndryshme.*

Këtë Debat e kryesoi Dr. Haxhi Ibishi - Kryesues i Kuvendit të Komunës ndërsa ishin prezent një numër i konsiderueshëm i publikut dhe drejtoret e drejtorive të Komunës.

Mbledhjen e hapi Dr. Haxhi Ibishi i cili pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe Ju uroi mirë së ardhje në këtë debat tha së Kryetari i Komunës z. Sokol Bashota për arsyen zyrtare nuk ka mundur të marr pjesë në këtë debat andaj unë së bashku me ju do të debatojmë për rrjedhat e qeverisjes në Komunën tonë në gjashtëmujorin e parë të këtij viti siç janë : të arriturat , synimet për të ardhmen dhe investimet kapitale, Ju qytetar të nderuar jeni të lirë të parashtroni pyetje për gjithçka ju intereson , prezent janë edhe drejtoret e drejtorive të Komunës dhe së bashku do të ju epen përgjigjet.

Ne jemi të interesuar që në debatet që mbahen me publikun të kemi një pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve dhe shpresoi këtë do ta arrijmë me forma të ndryshme.

Paraprakisht për projektet e realizuara në këtë gjashtëmuajor si dhe projektet që do të realizohen në vazhdim si ndërtimi i shkollës në fshatin Përqevë, ndërtimi i shkollës në fshatin Jashanicë, kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Pogradjë, hapja e puseve(bunarëve) për skamnorët në fshatin Qupevë, qumështorja në fshatin Jashanicë e shumë projekte të tjera që janë në procedurën e tenderimit që pritet të realizohen në vazhdim.

Prandaj në këtë debat qytetar të nderuar jeni të lirë që te i paraqitni hallet, problemet e Juaja, unë e hapi debatin- kush e donë fjalën?

Bekim Gashi nga Kлина tha së Ne si kërkesë shumë me rëndësi e kemi asfaltimin e rrugës mbi stacion të trenit që shkon tek lagja e jonë pastaj kemi nevojë për ujësjellës dhe për meremetimin e rrjetit elektrik unë nuk e di a ka mundësi Komuna të na ndihmoi në realizimin e këtyre tri projekteve.

Prekë Gojani nga fshati Budisalc- tha së ky fshat nuk ka përfitua nga Komuna po thuaj së në asnje projekt përpos që për projektin e kanalizimit të ujërave të zeza na janë dhenë 50 mijë €, për realizimin e këtij projekti ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë.

Gazmend Bojaj nga Kлина tha së asfaltimi i rrugës për në është mjaft me prioritet andaj kërkojmë nga Komuna që rruga “Lidhja e Pejës” ne lagjen e Malizhganit sa më parë që është e mundur të asfaltohet.

Llesh Veseli nga fshati Budisalc tha së që 15 vjet jam përfaqësues i fshatit dhe jam munduar ta jap kontributin tim për të mirën e këtyre banorëve, me brengos fakti së janë përhapur disa fjalë së Llesh Veseli si anëtar i LDK-së dhe Prekë Gojani si anëtar i AAK-së janë duke e penguar realizimin e projektit të kanalizimit të ujërave të zeza gjë që kjo nuk është e vërtetë. Në jemi angazhuar në shtrirjen e rrjetit të kanalizimit dhe kemi hasur në vështirësi të shumta, është dashur që vetë Komuna ta bëjë shtrirjen e rrjetit, por ne e kemi përgatitur projektin dhe javën e ardhshme do të ja dorëzojmë Komunës.

Dr. Haxhi Ibishi tha së unë Ju garantoi së në mbledhjet e Kuvendit askush nuk i ka thënë këto fjalë.

Skender Merturi tha së ka filluar një ndërtim i një objekti tek shëtitoreja afér lumit a ka leje të ndërtimit ?

Arif Elezaj nga fshati Gjurgjevik i Vogel tha së për këtë fshat nevojë e kahmotëshme është kanalizimi i ujërave të zeza, pos kësaj kemi problem me ujin që na vjen nga ujësjellësi që gjatë verës 4-5 muaj nuk kemi asnje pikë uji dhe problemi tretë janë qenët endacak që është shtuar shumë numri i tyre dhe paraqesin rrezik jo

vetëm për fëmijët por për njerëzit në përgjithësi a do të ndërmerret ndonjë masë nga Komuna për këtë dhe mendoi së është e nevojshme që sa më parë të bëni diçka.

Agron Gashi nga fshati Sferkë tha së puna që është bërë nga Komuna është për tu përshëndetur por në fshat ka një kohë që nuk ka ujë fare andaj duhet që Komuna sa më parë të ndërhyj tek kompania “Hidrodrini” që të rregullohet sa me parë ujësjellësi.

Ndrecë Gojani nga fshati Rullovc tha së kemi probleme me vërshimet e shpeshta që po bëhen në fshat për shkak të një kanali të ujit që vjen nga Zllakuqani ky kanal e tek një urë e ka daljen shumë të ngushtë mbushet me mbeturina dhe uji nuk depërtonte dhe përhapet nëpër ara dhe vjen tek lokalim, në vitin e kaluar për shkak të vërvimeve kam pasur dëme mjaftë të mëdha ka qenë një komision nga Komuna me berë vlerësimin e dëmit pos kësaj kemi probleme me ujërat e zeza, pyeti së kur do të bëhet kanalizimi i këtyre ujërave.

Dukagjin Gashi nga fshati Doberdol tha së unë vetëm një pyetje e kam:
A është edhe fshati Doberdol pjesë e Komunës së Klinës?

Hasan Banushi nga Klina shprehu shqetësimin e tij për shkatërrimet që po bëhen në shëtitoren afér lumbit, unë mendoi së të gjithë qytetarët duhet të kujdesën që të mirëmbahet ajo shëtitore e jo të rrënohet, policia duhet që ma shpesh të bejë patrullime.

Pasi që me nuk pati pyetje apo shqetësimë të tjera nga Publiku Kryesuesi i Kuvendit **Dr. Haxhi Ibishi** i ftoi drejtorët e drejtive përkatëse që të jepin përgjigjet e tyre .

Baki Gashi-drejtor i drejtorisë së Urbanizmit: sa i përket pyetjes së parë për asfaltimin e rrugës mbi stacion të trenit- ky projekt është në procedim e sipër, ndërsa sa i përket projektit të kanalizimin në fshatin Budisalc Ju jeni vonuar pak me shtrirjen e rrjetit e sa i përket thashë themëve ne nuk merremi me to, e për projektin e kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Gjurgjevik i Vogel Ne do të angazhohemi që sa me shpejt ta realizojmë.

Kolë Prenaj- drejtor i drejtorisë së Inspepcionit tha së ndërtimi i afér shëtitores afér lumbit është në procedurë për ndërtim por leje të ndërtimit nuk ka.

Gjokë Lleshi drejtor i drejtorisë për Shërbime Publike tha së për qentë endacak shumë shpejt do të gjendet një zgjidhje
Jemi në procedurë të tenderimit për grumbullimin e tyre, meqenëse me Ligj është i ndaluar eliminimi i tyre.

E sa i përket defekteve që janë shfaqur në ujësjellësin e fshatit Sferkë si duket po behën me qellim për motive politike, ndërsa sa i përket kanalit të ujit që vjenë nëpër fshatin Radullovci që e ka derdhjen shumë të ngushtë ne do të marrim masat e duhura.


Agron Gashi tha së sa i përket ujësjellësit këtu motive politike nuk ka dhe nuk pajtohem me këtë vlerësim për atë unë thash së pa ndërhyrjen e Komunës tek kompania “Hidrodrini” nuk ka asgjë.

Ramiz Rrusta-drejtor i drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim tha së ne jemi drejtori që inkasojmë mjete financiare dhe shtoi së për investime kapitale i kemi dy (2) milion e 200 mijë €, e dihet së për çdo projekt qytetarët duhet të participojnë me 30% të mjeteve financiare.

Dr. Haxhi Ibishi tha së është mirë që të rritën urat e komunikimit në mesë qytetarëve dhe Komunës sonë, unë ju garantoi së çdo Vendim do të jetë transparent dhe së qasja e kryetarit të Komunës z. Sokol Bashota është balancuese dhe shumë e përgjegjshme.

Me kaq mbledhja e debatit me qytetar përfundoi ne orën 11:20.

Procesmbajtësi,
Bedir Gashi



Kryesuesi i takimit me Publikun
Dr. Haxhi Ibishi